

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Mirembajtja dhe zhvillimi i sistemit elektronik te taksave dhe tarifave vendore”

**KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 50312310-1
VLERA E FONDIT LIMIT: 2.000.000 leke (Pa tvsh)**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kamez, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës 3 .;

b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Vlera e xhiros për të paktën një nga tre vitet e fundit financiar nga data e publikimit duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. *Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën.*

2.2.2 Kopje te vërtetuara te bilanceve te vitit, 2019, 2020, 2021 te konfirmuara nga Organi Tatimor.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk kanë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nenligjore në zbatim të tij

2.2.3 Një dokument që vërteton se (subjekti juaj) i ka plotësuar të gjitha detyrimet të maturuara të taksave dhe tarifave vendore të vitit 2022, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë këtë dokument).

Argumentimi: Kriteri i pikës 2.2.3 u vendos në referencë të nenit 76, pika 2 të ligjit 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ligjit nr.9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” dhe konkretisht në Neni 5, Rregulla të përbashkëta për taksat vendore, dhe në KREU II, Taksat Vendore, Neni 9, Llojet e taksave vendore, të Ligjit Nr.9632, datë 30.10.2006 Për Sistemin E Taksave Vendore, (i ndryshuar).

Për kapacitetin teknik:

2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të ketë realizuar, shërbime të ngjashme me objektin e këtij prokurimi të pakten në vlerën totale 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

- Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik, në rastin e kontratave të realizuara me një ent publik, duhet të paraqesë kopje të kontratave të ngjashme si dhe vërtetimet e realizimit të shërbimit të lëshuara nga enti publik ose/dhe faturat tatimore perkatëse të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- Për të vërtetuar këtë Operatori Ekonomik, në rastin e kontratave të realizuara me sektorin privat, duhet të paraqesë kopje të kontratave të ngjashme si dhe faturave tatimore perkatëse të shitjes ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 41, pika 3 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të

ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë jo më pak se 15 të punësuar në një periudhë jo më pak se 3 muajore para datës së shpalljes së kësaj procedure prokurimi.

- Per vertetimin e kësaj Operatori ekonomik duhet të paraqesë një Vertetim nga Organet Tatimore mbi numrin e të punësuarve.

Shenim- Per të përmbushur këto kriter në fazën e ofertimit është e mjaftueshme paraqitja e deklaratës, sipas shtojcës nr.8, ndërsa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, në përputhje me nenin 26.6 të VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, duhet të dorëzojë dokumentacionin

datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”.

*Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar në afatin, orët e punës dhe pagën minimale të lejuar, që duhen për të përmbushur zbatimin e kontratës. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje tregon besueshmëri për autoritetin. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë çdo dëshmi me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve dhe përvojën e tyre, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomik, përpiket të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosija e kriterit për një punësim te **paktën 15 (pesëmbëdhjete) personave ..***

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me Çertifikatat:

2.3.4.1 Çertifikate ISO 9001 të Menaxhimit të Cilësisë ose ekuivalent cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen dhe certifikata duhet të jetë aktive

2.3.4.2 Çertifikate ISO 27001 e Sistemit Menaxhial të Sigurisë së Informacionit ose certifikate ekuivalente e cila duhet të jetë në të njëjtën fushë me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve që prokurohen dhe certifikata duhet të jetë aktive.

Çertifikate ISO 20000 - 1 te Sistemit Menaxherial ose ekuivalent cila duhet te jete ne te njëjtën fushe me kategorinë dhe specifikën e shërbimeve qe prokurohen dhe certifikata duhet te jete aktive

Argumentim: Nisur nga proceset e punes kritike, rendesise se sistemit dhe shërbimeve qe ai ofron, gjykohet e arsyeshme qe operatori ekonomik proceset e punes se tij, ti bazoje ne standarde boterore, te cilat ne menyre direkte ndikojne ne cilesi, shpejtesi, efikasitet dhe te shërbimeve te ofruara.

Sistemi i menaxhimit të cilësisë siguron që operatori zotëron aftësitë për të ofruar shërbime që plotësojnë pritshmëritë kërkesat dhe specifikimet e klientit përmes aplikimit efektiv dhe cilesor të tij.

Sistemi i menaxhimit te sigurise se informacionit siguron qe operatori ekonomik aplikon, mirëmban dhe përmirëson në mënyrë të vazhdueshme një përjasje sistematike në menaxhimin e informacionit sensitiv me fokus tek siguria

Menaxhimi i shërbimit IT siguron qe operatori ekonomik ka të implementuar një sistem ofrimi të shërbimit përmes të cilit efektivisht planifikon, implementon, operon, monitoron, kontrollon dhe mirëmban portofolin e shërbimeve dhe cilësinë e tyre.

2.3.5.1 Te kete te punesuar jo me pak se 5 (pese) specialiste IT te diplomuar ne fushat si: *Informatike, Informatike ekonomike, Inxhinieri Elektronike* e fusha te tjera te ngjashme. Te pakten 2 nga keta specialiste te kene pervoje jo me pak se 10 vjecare ne projekte te ngjashme ne fushen e IT.

2.3.5.2 Të paktën 1 (një) nga specialistet e mesiperme te jete i certifikuar si *Drejtues Projektesh* ne fushen e IT dhe me pervoje jo me pak se 10 vjecare ne fushen e IT.

2.3.5.3 Te kete te punesuar nje specialist ekonomik me eksperience pune jo më pak se 10 vjeçare dhe me eksperience pune ne sektorin e taksave dhe tatimeve.

Për të vërtetuar këtë Operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- CV e specialisteve
- Diplomat e specialisteve
- Deklarata “Listëpagesat e kontributeve te sigurimeve shoqerore e shendetesore dhe tatimit mbi ardhurave nga punesimi” per periudhen 3 mujore, te vertetuar nga organet tatimore.

Argumentim: Ky kriter demonstroi aftësinë e operatorit ekonomik për të planifikuar, zbatuar, operuar, monitoruar, shqyrtuar, zgjidhur problematika që do të raportohen gjatë implementimit dhe gjatë periudhës së garancisë së pajisjeve të prokuruar.

Operatori Ekonomik duhet të ketë të paktën një punonjës të certifikuar në fushën e IT, në mënyrë që ndryshimet e portalit të testohen sipas praktikave më të mira, përpara se të publikohen.

Personeli i mësipërm duhet të ketë aktualisht një marrëdhënie pune me ofertuesin të pakten 3 muaj e fundit nga data e publikimit të procedurës, e vërtetuar kjo me formularin e E-sig 025 të listpagesave të deklaruara, të konfirmuara nga Drejtoria e Tatimeve.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.